VENDIM

Këshilli i Nderit pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë

Në mbledhjen e mbajtur më 10 dhjetor 2024, Këshilli i Nderit, në përbërje: Ognen Janeski (kryetar), Mira Kostiq, Emilija Misirlievski, Aleksandar Samarxhiev dhe Besim Shabani, duke vepruar mbi ankesën e paraqitur nga Vesna Poposka kundër medias Faktor.mk**,** në lidhje me artikullin "Cila është zonja që e zëvendësoi shopingun me blerjen e 100 aksioneve në NLB Bankë, duke paguar 80.000 euro brenda një dite?", të publikuar më 20 nëntor 2024, mori këtë:

VENDIM

HEDH POSHTË ankesën e Vesna Poposkës kundër medias Faktor.mk**.**

ARSYETIM

Këshilli i Nderit shqyrtoi ankesën dhe konstatoi sa vijon:

- Artikulli ka karakteristika të një shkrimi komercial, me mundësi për marketing të fshehur. Edhe pse nuk është shënuar qartë si përmbajtje e sponsorizuar ose e paguar, mënyra se si janë paraqitur informacionet mund të krijojë përshtypjen se artikulli ka një qëllim komercial.
- Nuk është konstatuar shkelje e neneve 10, 11, 13 dhe 15 të Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë, megjithatë, struktura e artikullit mund të ishte më e qartë për të shmangur një ton spekulativ.

KONKLUZION

- **Këshilli rekomandon** që mediat të shënojnë qartë përmbajtjet komerciale ose të sponsorizuara, për të shmangur keqkuptimet tek lexuesit dhe për të siguruar transparencë. Nëse artikulli është një tekst autorial i një gazetari/eje ose një koment redaksional, kjo duhet të shënohet qartë në nënshkrimin e autorësisë.

- **Këshilli rekomandon** që në të ardhmen të shmanget raportimi me anshmëri gjinore, madje edhe në tekstet komerciale, dhe që mediat të mos sugjerojnë stereotipe që kufizojnë rolin e grave në botën e biznesit.

Vendimi do të publikohet në faqen zyrtare të SHGM**.**

Vendosur në Shkup, më 10 dhjetor 2024
Këshilli i Nderit pranë SHGM
Kryetar: Ognen Janeski
Anëtarë: Mira Kostiq, Emilija Misirlievski, Aleksandar Samarxhiev, Besim Shabani